**Universiteti i Tiranës**

**Fakuleti i Historisë dhe Filologjisë**

**Departamenti i Gjeografisë**

**KONKURS MBI PUNËT KËRKIMORE JSTORE**

**FUSHA E APLIKIMIT:** Ekonomi

**TEMA:** Ish-rrethi i Lushnjes ose ndryshe "Hambari i Myzeqesë"

**Punoi:** Blerina Saraci

Master Profesional GIS i Aplikuar, Viti I

**Tiranë, 2021**

## I. Hyrje

Lushnja, një ndër qytetet kryesore të Shqiperisë për furnizimin me produktet e saj bujqësore, ku sot ajo njihet ndryshe edhe si “Hambari i Myzeqesë”. Që në fillesat e tij ky qytet është cilësuar si një vend bujqësor-industrial, ku peshën më të madhe të ekonomisë e ka luajtur dhe vazhdon ta luajë bujqësia dhe më pak degët e tjera të ekonomisë. Pavarësisht kësaj, vitet e fundit ka marrë një rëndësi të vecantë edhe sektori i tretë i ekonomisë, ai i tregtisë, turizmit, shërbimeve etj, gjë që ka ndikuar pozitivisht në rritjen ekonomike të qytetit.

Pavarësisht kësaj, nuk mund të themi se qyteti është në nivelin e duhur ekonomik dhe për këtë arsye ish-rrethi i Lushnjes duhet të hartojë plane strategjike, që të kenë në fokus dy sektorët e parë të ekonomisë, atë bujqësor dhe industrial, por pa neglizhuar as sektorin e tretë të ekonomisë, sepse rëndësia e tij po shtohet  në cdo vend të botës.

Fillimisht ish-rrethi i Lushnjes duhet të mbështetet në disa objektiva strategjike zhvillimore si:

1. Mbështetje e zhvillimit të qëndrueshëm të bujqësisë, blegtorisë dhe agropërpunimit, si sektor kryesor të ekonomisë dhe punësimit.
2. Mbështetje e sektorit të ekoturizmit, si sektor mbështetës dhe plotësues i bujqësisë.
3. Mbrojtja e burimeve natyrore si baza për zhvillimin ekonomik dhe mirëqënie të qytetarëve.
4. Krijimin e pikave të gumbulimit dhe ruajtjes së produkteve të freskëta bujqësore.
5. Ngritjen e impiantit të seleksionimit, sistemimit dhe paketimit të produkteve bujqësore.
6. Ngritjen e një tregu të shitjes me shumicë, i mbështetur në një rrjet pikash tregtimi.
7. Përmirësimin e rrugëve ndërkomunale, për të lehtësuar transportin si të banorëve të zonave rurale, ashtu edhe për të lehtësuar transportin e mallrave bujqësorë.
8. Rehabilitimin e pyjeve, duke u kujdesur dhe duke i shtuar ato. Po ashtu edhe duke mbështetur shtimin e prodhimit të ullinjëve.

Në zbatim të këtyre objektivave ekonomia e këtij territori do të ketë një përmirësim rrënjësor, duke e cuar atë në nivel të lartë ekonomik.

## II. Karakteristikat e zhvillimit ekonomik të ish-rrethit Lushnje në periudha të ndryshme

### Zhvillimi ekonomik para viteve 90'

Lushnja, që në fillesat e saj është marrë me aktivitete bujqësore dhe zejtari. Vetëm pas vitit 1870, Lushnja u kthye në një qendër të rëndësishme tregtare midis tregjeve të Beratit, jugut dhe veriut, ndërsa tregtia e jashtme realizohej sic është edhe në ditët e sotme me shtetet kryesore që vendi ynë eksporton si : Itali, Greqi dhe Turqi.(Joseph S. Roucek, 1933)

Tregtia e brendshme e bashkisë zhvillohej në pazaret që ndodheshin në fshatra të ndryshme në ditë të ndryshme të javës. Prodhimet kryesore që eksportoheshin në këto vite ishin: vaji, lëkura, leshi, bagëtitë, zhuga, gruri, misri, tërshëra, elbi, etj. Zejtarët e Lushnjes njiheshin për përpunimin e zhugës, kashtës si dhe shquheshin si teneqepunues, bakërpunues e furrtarë. Tregtia ndihej shumë pak në këtë periudhë dhe zhvillimi ekonomik ishte shumë i ulët, saqë sillte edhe shumë pasoja negative në jetën e banorëve, kjo e gjithë në ekonominë e paraluftës, por një ndryshim i madh ndodhi në periudhën e re paslufte.(Derek R.Hall, 1990)

Pas Luftës së Dytë Botërore ccdo gjë ndryshoi, filloi i procesi i industrializimit dhe i urbanizimit, ku peshën kryesore të zhvillimit e mbante industria, sidomos ajo e lehtë e lidhur me bujqësinë dhe blegtorinë, të cilat siguronin lëndën e parë për prodhim, më pas vinin shërbimet dhe tregtia. Prodhimi industrial deri në vitin 1983 ishte rritur 68 herë krahasuar me atë të vitit 1950. Në v.1987, Lushnja jepte 5.54% të prodhimit të industrisë së lehtë në të gjithë vendin, nga 1.25% në vitin 1960.( Dhimitri.J, 2008)

Fillimi i Industrisë nis në vitin 1946 me krijimin e kooperativave të para si bujqësore dhe industriale. Në këtë periudhë janë ndërtuar dhe shumë ndërmarrje industrial që mbanin edhe peshën kryesore të ekonomisë, ku ndër to mund të përmendim ndërrmarje të industrisë ushqimore, të letrës etj. ( Dean S. Rugg,1994)

Më pas janë ndërtuar shumë vepra të tjera bujqësore dhe industriale, ku në 1947-1955 u fillua me plugimin, mbjelljen e pambukut dhe të grurit. Në 1959 vihet në shrytëzim fabrika e prodhimit të tullave, në 1964 filloi prodhimi nga fabrika e përpunimit të rrushit, në 1966 filloi prodhimi në fabrikën e letrës dhe kartonit, 1976 kemi shfrytëzimin e fabrikës së plastmasit, në

1976-1980 fillon funksionimi i fabrikës së miellit dhe më pas kemi funksionimin e fabrikës së vajit, salcës, konservimit të frutave dhe perimeve. Jetesa dhe kujdesi shëndetësor u përmirësua edhe me hapjen e në vitet 1956-1960 të spitalit të qytetit. (Dhimitri. J, 2008)

Në sektorin bujqësor në periudhën e pasluftës filloi dhe bonifikimi tokave bujqësore, sepse sic dihet Fusha e Myzeqesë ka qenë e kenetëzuar dhe me anë te bonifikimit ajo u kthye në tokën bujqësore dhe më pjellore të Shqipërisë. Në atë periudhë iu kushtua vëmendje plehërimit të tokave duke iu rritur atyre produktivitetin. Tokat bujqësore u ndanë në sektorë të ndryshëm sipas produkteve bujqësore që kultivonin. Të gjitha produktet bujqësore filluan të prodhoheshin dhe të tregëtoheshin, por më e rëndësishmja është se e gjithë popullsia ishte e punësuar, duke filluar që nga mosha 15 vjec. Po ashtu në këtë periudhë filloi edhe të shtohej numri i popullsisë dhe vendi të kishte një popullsi relativisht të re. ( Dean S. Rugg, 1994)

**Zhvillimi ekonomik pas viteve 90' deri më sot**

Me rënien e regjimit komunist jo vetëm në Lushnje, po kudo në Shqipëri, filloi të shkatërrohej cdo gjë. Shumë fabrika u shkatërruan, u plackiten, cdo gjë u rikthye përsëri si në fillim. Vendi filloi një periudhë të re tranzitore dhe ekonomia ra ndjeshëm. Popullsia nisi të migrojë si brenda vendit, po ashtu edhe jashtë tij duke lënë cdo gjë pas. ( Xhomo. A, 1999)

Sic e përmendëm më sipër që në Lushnje u ndërtuan shumë fabrika të ndryshme, prej tyre mbeti vetëm një numër i vogël. Popullsia iu rikthye përsëri bujqësisë, këtë herë duke ndërtuar serat bujqësore, gjë e cila i favorizonte për daljen sa më shpejt në treg të produkteve bujqësore, duke iu mundësuar sado pak fitim fermerëve. Sot në këtë bashki gjenden vetëm disa degë të industrisë, të cilat janë: industria ushqimore, e prodhimit të materialeve të ndërtimit, industria e prodhimit të produkteve dhe materialeve plastike.

Në krahasim me qytetet e tjera, Lushnja paraqet potencialin më të madh të zhvillimit të bujqësisë, kjo sepse rreth 77% e Fushës së Myzeqesë ndodhet përdoret për qellime bujqësore, ku dhe aktiviteti i banorëve të këtij territori është i lidhur me prodhimin dhe përpunimin e këtyre produkteve. Po ashtu sot në këtë bashki janë shtuar edhe bizneset që janë të vendosura përgjatë autostradës dhe rrugëve lidhëse brenda saj. Në këtë territor operojnë 3048 ndërmarrje, ku 2582 i përkasin kategorisë së biznesit të vogël dhe 466 biznesit të madh. Duke qenë së vite më parë përparësi kishte bujqësia, sot mund të themi se tregtia është ajo që mban peshën kryesore me 57%

, bujqësia me 23% dhe pjesa tjetër që mbëtet i përket transportit dhe magazinimit. ( Bashkia Lushnje, 2016)

**III. Sektori primar: Roli dhe vendi që zë bujqësia në eknominë e ish-rrethit Lushnje**

Duke parë potencialet e shumta bujqësore që ka Shqiperia, shohim që edhe niveli i eksporteve është shtuar. Është zgjeruar harta e tregëtimit të mallrave bujqësore edhe me shtete të tjerë sic janë: Mali i Zi, Maqedonia, Bullgari, Serbi, Greqi, Kosovë, Francë, Gjermani dhe Itali. Për arsye të shtimit të produkteve bujqësore dhe rritjen e numrit të eksporteve, vendit tonë i është nevojitur të ndërtojë disa pika grumbullimi të frutave dhe perimeve, sot operojnë 117 pika grumbullimi në gjithë vendin. ( Michael Kaser, 2001)

Lushnja zë vendin e parë për këto pika grumbulimi, ku sipas raportit të 2016 rezultojnë 13 pika të grumbullimit dhe eksportit të fruta perimeve me një kapacitet grumbullues 5100 $m^3$ dhe dhoma frigoriferike me kapacitet 7500 ton duke garantuar në këtë mënyrë grumbullimin e 56000 ton prodhim nga fushat e fermave. Po ashtu kemi dhe aktivitetin e serave diellore ku numri total i tyre shkon në 2610 sera diellore të shtrira në një siperfaqe prej 363 ha, duke zotëruar kështu numrin më të madh të serave në vend në rang bashkie. Aktiviteti i këtyre serave lidhet me prodhimtarinë e domates dhe perimeve, ndërsa një pjesë tjetër lidhet me prodhimtarinë e luleshtrydhes, e cila ka një peshë kryesore në eksportin e mallrave. Ky frut është shumë i kërkuar si brenda ashtu edhe jashë vendit, dhe për këtë arsye fermerët e kanë rritur sasinë e prodhimit të luleshtrydhes. Por rëndësi të vecantë i jepet edhe pemtarisë në këtë territor, e cila ndodhet në pjesën kodrinore të saj, ku vitet e fundit shohim që janë shtuar shumë ullishtet, vreshtat dhe pemët frutore. Kjo është një gjë e mirë për këtë territor pasi ndikon shumë në zhvillimin ekonomik të saj. Përsa i përket prodhimit blegtoral njësitë që kryesojnë në këtë fushë janë njësitë administrative Kolonjë, Krutje dhe Bubullimë. Shifrat e prodhimtarisë së qumështit në këto njësi arrijnë nga 80000 kv deri në 120000 kv, ndërsa prodhimtaria e mishit arrin 7000-11830 kv. Por gjithashtu mund të përmendim edhe numrin e madh të baxhove që operojnë në këtë bashki, si dhe dy kompanitë e mëdha të përpunimit të qumështit Lufra dhe Delta. ( Bashkia Lushnje, 2016)

**Llojet e kulturave bujqësore dhe strategjia e konkurrimit në treg**

Sic e kemi thënë edhe me sipër që territori i ish-rrethit Lushnje shtrihet në Ultësirën e Myzeqesë dhe tokat e saj janë toka bujqësore. Në këto toka bujqësore të bashkisë prodhohen kryesisht drithëra, si grurë, misër dhe tërshërë, prodhohen perime të ndyshme, patate, fasule dhe foragjerë. Po ashtu kemi edhe prodhimin e drurëve frutorë, si vreshta, ullinj, pemë frutore dhe agrumet.

Këto janë disa nga kulturat bujqësore që kultivohen në këtë territor, por janë edhe shumë të kërkuara si në tregun vendas ashtu edhe në atë të jashtëm. Kjo rritje e kërkesës rrit gjithashtu edhe komkurrencën në treg, pasi shumë vende të tjera kërkojnë te arrijnë nivelin e ish-rrethit Lushnje në kultivimin e produkteve bujqësore. Për këtë arsye duhet të hartohen disa strategji për zhvillimin ekonomik.

Disa strategji mund të jenë:

1. Të ekonomizohet prodhimi dhe të rritet niveli i eksportit si brenda dhe jashtë vendit, nëpërmjet ngritjes sa më shumë të pikave të grubullimit, magazinimit dhe dhomave frigoriferike, të cilat do ta ulin ndjeshëm sasinë e dëmtimit dhe prishjes së ushqimeve.
2. Nxitja e krijimit dhe funskionimit real të shoqatave të fermerëve me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe partneriteteve për ekonomizimin e tokës bujqësore dhe rritjen e prodhimtarisë së kulturave bujqësore.
3. Krijimi i një klime të favorshme për investitorët e huaj dhe vendas në fushën e industrisë së përpunimit të produkteve bujqësore, kryesisht ullirit, frutave dhe produkteve blegtorale, si qumështi dhe veza.
4. Ulja e shkallës se papunsisë, duke hapur vende të reja pune, me qëllim uljen e nivelit të papunësisë. Hapjen e shkollave profesionale bujqësore, ku te rinjtë të aftësohen në sektorin e bujqësisë, si agroturizmi, inxhinieria ushqimore dhe energjitike.

## IV. Sektori sekondar: Potencialet natyrore për zhvillimin e industrisë

Ish-rrethi i Lushnjes ka qenë një vend shumë i industrializuar në periudhën e regjimit komunist, ku në këtë periudhë janë ndërtuar shumë industri të llojeve të ndryshme dhe peshën kryesore të tyre e mbante industria e lehtë, të cilën e kemi të pranishme edhe në ditët e sotme. Zhvillimi i industrisë në këtë qytet është i lidhur kryesisht me prodhimet bujqësore, e cila është dhe lenda e parë për industrinë. Lushnja i ka ende edhe sot mundësitë për ndërtimin e degëve të ndryshme të industrisë, duke qenë se gëzon edhe 50 ha hapësirë industriale, por duhen hartuar disa strategji për zhvillimin e tyre në të ardhmen. ( Kume. V & Llaci. Sh, 2000) Disa nga strategjitë mund të themi se janë:

- Rimëkëmbja e ish-godinave të vjetra të degëve të industrisë dhe rikonstruktimi i tyre.
- Shfrytëzimi i potencialeve natyrore në mënyrën e duhur, pa e dëmtuar vendburimin e potencialeve natyrore, por pa dëmtuar dhe mjedisin përreth.
- Duhet të hartohen plane për vendosjen e godinave të industrisë në zona ku terreni është i përshtatshëm për to.
- Hartimi i planeve për zhvillimin sa më efikas të degëve të industrisë, duke i dhënë përparësi lëndës së parë që ish-rrethi i Lushnjes, pasi në varësi të saj mund të vendoset dhe cila degë e industrisë duhet të zhvillohet në këtë bashki.
- Në guroren e njësisë admninistrative Karbunarë duhet të shfrytëzohet në mënyrën e duhur burimet e saj dhe me mjete sa më efikase, pa e kaluar limitin e shfrytëzimit te tyre.

Ish-rethi i Lushnjes ndonëse nuk është një vend që ofron shumë mundësi për zhvillimin e degëve të industrisë, por është një vend i përshtatshëm për ofrimin e mundësive për zhvillimin e disa degëve te saj të lidhura me produktet e bujqësore. Produkte këto që sot i gjen në cdo stinë të vitit falë mundësive dhe kushteve natyrore që ky territor ka dhe ato pak degë industrie që ka arrijnë ta sigurojnë lëndën e tyre të parë.

## V. Sektori terciar: Zhvillimi dhe problematikat aktuale

Lushnja falë pozitës së saj të favorshme gjeografike dhe shtrirja e saj përgjatë akseve kryesore rrugore kanë bërë që sektori i tretë i ekonomisë të zhvillohet më së shumti. Sot në këtë territory operojnë shumë biznese si të vogla po ashtu edhe të mëdha. Shumica e tyre janë të vendosura përgjatë autotostradës Lushnje-Fier dhe përgjatë pjesës tjetër të autostradës në veri të territorit. Gjithsej mund të themi se ish-rrethi i Lushnjes ka aktualisht 3048 ndërmarrje, ku 2582 janë biznese të vogla dhe 466 i përkasin biznesit të madh. Nga këto biznese pjesa më e madhe është e vendosur në njësinë e qytetit me 1689 ndërmarrje të biznesit të vogël dhe 341 ndërmarrje të biznesit të madh, më pas vjen njësia administrative e Kolonjës, Fier-Sheganit dhe Krutjes.

Për sa i përket ndarjes së këtyre bizneseve sipas llojit ekomomik kemi mbizoterimin e karakterit tregtar me 57%, ku sic e thamë më sipër pjesa më e madhe e tyre janë të vendosura në qytetin e Lushnjes , të cilat i referohen tregtimit  të produkteve ushqimore, konfeksione, artikuj të ndryshëm,etj. Më pas në vend të dytë kemi bizneset në varësi të bujqësisë  me 23% në njësitë administrative Kolonjë, Krutje dhe Dushk. Por nuk duhet harruar që edhe magazinimi e transporti zënë një pjesë të rëndësishme në ekonominë e keëaj bashkie, pasi janë hallkat kryesore të tregtimit të të gjitha produkteve tregëtuese.

Ndonëse ky territor gëzon shumë mundësi për zhvillimin e sektorit terciar të ekonomisë, ajo has edhe shumë probleme të tjera në varësi të tij si :

- Papunësia për shkak të operimit të madh të bizneseve të vogla, ku sic e përmendëm më sipër janë 2582 ndërmarrje të biznesit të vogël. Kjo bën që mos të ketë shumë vende të lira pune.
- Migrimi është një fenomen që është i pranishëm në të gjithë Shqipërinë, jo vetëm në territorin e ish-rrethit Lushnje. Kjo ka bërë që të ulet numri i popullsisë në këtë territor.
- Duke qenë e prirur më së shumti drejt ekonomisë bujqësore, niveli ekonomik i këtij territori është i ulët dhe për këtë arsye fuqia blerëse është e ulët, pasi edhe niveli i cmimeve është i lartë krahasuar me buxhetin familjar të banorëve.

## Përfundime

Duke u bazuar në të dhënat e këtij studimi arritëm në disa konkluzione, të cilat janë:

- Ekoniomia e ish-rrëthit Lushnje është e orientuar drejt sektorit të bujqësisë, blegtorisë, tregtisë, shërbimeve dhe industrisë së lehtë.
- Para viteve 90' prioritet në këtë territor, si në të gjithë vendin ku përparësi iu dha industrisë dhe ndërtimit të një numri të madh fabrikash me funksion të ndryshëm.
- Pas rënies së regjmit komunist fabrikat dhe uzina e ndërtuara në atë periudhë u shkatërruan dhe vendi iu kthye përsëri sektorit të bujqësisë, i cili edhe sot ka prioritetin më të madh në këtë territor.
- Pozita e favorshme gjeogrfike që ish-rrethi i Lushnjes gëzon, bën të mundur që përgjatë akseve kryesore rrugore të shtrihet dhe të marrë një rëndësi të madhe sektori i tretë i ekonomisë.
- Tregtia zë pjesën më të madhe të llojit ekonomik në sektorin e tretë dhe ndiqet më pas nga bizneset, si të mëdha ashtu e të vogla.
- Për shkak të orientimit më së shumti në ekonomine bujqësore, ka bërë që niveli ekonomik i këtij territori të jetë më i ulët në krahasim me territoret e tjera të vendit.

## Rekomandime

Nisur nga studimi dhe përfundimet e mësipërme pamë që ekononomia e ish-rrethit Lushnje nuk është në nivelet e duhura, pavarësisht se ajo mbahet si furnizuesi kryesor i vendit me produktet e saj bujqësore. Vërtetë ky territor është quajtur "Hambari i Myzeqesë", por politikat e ndërmarra nuk e lejojnë që të ketë një zhvillim të kënaqshëm. Për këtë gjë në arrijmë të japim disa rekomandime si më poshtë:

- Duke qenë se ish- Lushnje disponon potenciale natyrore dhe humane mjaft të mira, ajo duhet të hartojë plane strategjike për të mundësuar një zhvillim ekonomik sa më të lartë dhe efektiv.

- Duhet të mirëmenaxhohen potencialet natyrore që ky territor disponon, por pa i dëmtuar ato.
- Të merren masa për ndalimin e ndotjes së tokës nga pesticidet që fermerët përdorin në bujqësi.
- Po ashtu ish-rrethi i Lushnjes duhet të ndërmarrë masa për ndalimin e pesticideve që fermerët përdorin për pjekjen e shpejtë të prodhimeve të tyre, gjë e cila shkakton shumë sëmundje tek konsumatorët e këtyre produkteve.
- Nxitja e fermerëve për të krijuar shoqata për bashkëpunim midis tyre në mënyrë që të favorizojnë zhvillimin ekonomik të vendit.
- Të mundësohet mbrojtja e burimeve natyrore si baza për zhvillimin ekonomik dhe mirëqenia e qytetareve.
- Krijimin e pikave të grumbullimit duke e rritur numrin e tyre me qëllim mbajtjen e frutave dhe perimeve të freskëta.

**Bibliografia**


- Dhimitri. J, Studime Albanologjike IV Gjeografi, Departamenti i Gjeografisë, Fakulteti i Historisë dhe Filologjisë, Universiteti i Tiranës, 2008, fq.216
- Dokumenti i Strategjisë së Zhvillimit të Territorit, Bashkia Lushnje 2016, fq.51, 52, 53
- Hall, D. R. (1990). Albania: the last bastion? *Geography*, *75*(3), 268–271. http://www.jstor.org/stable/40571858
- Kaser, M. (2001). Economic Continuities in Albania's Turbulent History. *Europe-Asia Studies*, *53*(4), 627–637. http://www.jstor.org/stable/826465
- Kume, V., & Llaci, S. (2000). Albania, an ex-communist country during the transition period: problems and challenges. *Journal of East European Management Studies*, *5*(2), 103–129. http://www.jstor.org/stable/23280134
- Roucek, J. S. (1933). Economic Conditions in Albania. *Economic Geography*, *9*(3), 256–264. https://doi.org/10.2307/140835

- Rugg, D. S. (1994). Communist Legacies in the Albanian Landscape. *Geographical Revieë*, *84*(1), 59–73. https://doi.org/10.2307/215781
- Xhomo, A. (1999). Agricultural and food production in Albania. *SEER: Journal for Labour and Social Affairs in Eastern Europe*, *2*(4), 71–74. http://www.jstor.org/stable/43291678